



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT

RREGULLORE

E

INSTITUTIT TË KËRKIMIT

SHKENCOR TË SPORTIT

PËRMBAJTJA

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Statusi i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit
Baza ligjore e Rregullores
Objekti i Rregullores së IKSHS
Fusha e veprimit dhe efektet e rregullores së IKSHS

KREU II – ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I IKSHS

Misioni i IKSHS
Struktura dhe organizimi i IKSHS
Organet dhe autoritetet drejtuese të IKSHS
Asambleja e Personelit Akademik të IKSHS
Funksionet dhe detyrat e AIKSHS
Drejtoria e IKSHS
Drejtori
Zëvendës/Drejtori
Drejtuesi i njësisë bazë
Drejtuesi i Grupit Mësimor dhe Kërkimor
Raportimi Vjetor i IKSHS

KREU III – VEPRIMTARITË, FUNKSIONET DHE DETYRAT E IKSHS

Veprimtaritë e IKSHS
Kërkimi shkencor në IKSHS-Fushat kërkimore
Funksionet e IKSHS
Veprimtaritë kërkimore të IKSHS në kuadër të IKSHS
Kërkimi shkencor në IKSHS
Departamentet si njësi bazë kërkimore të IKSHS
Kontributi i IKSHS në procesin mësimor të UST
Shërbimet e IKSHS për të tretë
Laboratorët kërkimorë të IKSHS
Administrimi dhe rregullat e funksionimit e përdorimit të laboratorëve

KREU IV – PERSONELI I IKSHS

Kategoritë e personelit të IKSHS
Kategoritë e personelit akademik të IKSHS
Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik
Punësimi i personelit akademik të IKSHS
Të drejtat e personelit akademik të IKSHS
Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik të IKSHS
Personeli akademik i ftuar
Veprimtaria që kryen personeli akademik i IKSHS
Ngarkesa kërkimore vjetore për personelin akademik të IKSHS
Ngarkesa mësimore vjetore për angazhimin në mësimdhënies të personelit akademik të IKSHS
Viti akademik sabbatik
Personeli ndihmës-akademik

Personeli ndihmës-kërkimor i IKSHS
Personeli administrativ
Të drejtat e punonjësit ndihmës-akademik
Detyrimet e punonjësit ndihmës-akademik
Shkeljet disiplinore të personelit të IKSHS
Masat disiplinore të personelit të IKSHS

KREU V – BASHKËPUNIMI I IKSHS

Bashkëpunimi me njësitë kryesore të UST
Bashkëpunimi i IKSHS me institucionet dhe organizatat kombëtare
Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare

KREU VI – VLERËSIMI I CILËSISË

Sigurimi i brendshëm i cilësisë
Vlerësimi periodik i veprimtarive kërkimore-shkencore të IKSHS
Organizimi i vlerësimit
Detyrat dhe përgjegjësitë gjatë procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor
Organizimi i procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor

KREU VII – DISPOZITA TË FUNDIT

Rregulloret e Departamenteve
Interpretimi i Rregullores
Miratimi dhe ndryshimi i Rregullores
Hyrja në fuqi
Aktet e miratimit të Rregullores

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Statusi i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit

1. Institutit i Kërkimit Shkencor të Sportit, me akronim në gjuhën shqipe “**IKSHS**”, është institucion publik kërkimor-shkencor i arsimit të lartë, njësi kryesore e Universitetit të Sporteve të Tiranës “**UST**” me profil kryesisht kërkimor dhe shkencor. Emërtimi zyrtar i IKSHS në gjuhën angleze është “**Institute of Sport Research**”, dhe akronim “**ISR**”.
2. IKSHS është krijuar me VKM Nr.123, datë 17.02.2010, “për krijimin e UST”.
3. Selia e IKSHS ndodhet në mjediset e Universitetit të Sporteve të Tiranës.
4. IKSHS ka vulën, stemën dhe logon e vet, në kuadrin e UST.

Neni 2

Baza ligjore e Rregullores

Rregullorja e Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit mbështetet në në Ligjin "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, të ndryshuar, aktet nënligjore, udhëzimet dhe urdhërat që dalin në zbatim të tij, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Sporteve të Tiranës, specifikisht në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë detyrimet akademike kërkimore e mësimdhenien, statusin e stafeve akademike dhe administrative në IAL publike si dhe të gjitha aktet e tjera që rregullojnë procedurat dhe kriteret e kualifikimit të stafit akademik, kërkimin shkencor, publikimet dhe kriteret përkatëse si dhe rregullat mbi standartet e kërkimit, etikën në kërkim përfshirë plagjaturën dhe pronësinë intelektuale.

Neni 3

Objekti i Rregullores së IKSHS

Kjo rregullore ka si objekt rregullimin e veprimtarisë kërkimore, mësimore dhe administrative të IKSHS, në kuadrin e UST dhe në përputhje me misionin, objektivat zhvillimore dhe Statutin e Rregulloren e UST dhe krijimin e hapësirave të nevojshme për një menaxhim fleksibël në nivel Instituti të çdo departamenti e të stafit akademik dhe personelit ndihmës-akademik e administrativ përkatës.

- a. Rregullorja synon gjithashtu krijimin e një kuadri koherent dhe të plotë mbi kërkimin shkencor dhe menaxhimin e tij në kuadër të IKSHS;
- b. Kjo rregullore parashikon rregullat e veprimtarisë së personelit në përputhje me emërtimin e përshkrimet e vendit të punës dhe detyrat sipas përshkrimit të statusit në IKSHS;
- c. Rregullorja parashikon gjithashtu kriteret, rregullat dhe standartet e veprimtarisë kryesore, kërkimit shkencor dhe veprimtarinë mësimore e administrative në IKSHS, si dhe marrëdhëniet me njësitë e tjera kryesore në UST, institucionet e tjera kombëtare e ndërkombëtare të specializuara.

Neni 4

Fusha e veprimit dhe efektet e rregullores së IKSHS

1. Fusha e veprimit dhe efektet e kësaj rregullore shtrihen dhe përfshijnë të gjitha strukturat, autoritetet dhe organet drejtuese të IKSHS, njësitë bazë përbërëse, personelin akademik-kërkimor, ndihmës-kërkimor dhe administrativ të IKSHS.
2. Të gjitha njësitë bazë të IKSHS duhet të harmonizojnë rregulloret e tyre, aktet e tjera të brendëshme, si edhe veprimtarinë në përputhje me këtë rregullore. Ato mund të vendosin

kritere shtesë, por ato nuk duhet të jenë në asnjë rast më të ulëta ose më minimale se kriteret bazë të kësaj rregullore.

3. Rregulloret e brendëshme të njësive bazë miratohen nga Senati Akademik i UST-së, pas diskutimit në njësi dhe miratimit paraprak nga Drejtoria e IKSHS.

KREU II ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I IKSHS

Neni 5

Misioni i IKSHS

IKSHS, si njësi me profil kryesisht kërkimor dhe shkencor, përpunon e sintetizon mendimin shkencor të përparuar, që t'i paraprijë zhvillimeve shoqërore e kulturore, si dhe të shërbejë si një mbështetje e fuqishme për hartimin dhe përpunimin e politikave publike në fushat e aktivitetit fizik dhe sportit.

1. Misioni kryesor i Institutit të Kërkimit Shkencor është hartimi, zhvillimi dhe promovimi i platformave, programeve dhe projekteve të kërkimit shkencor dhe ndihmesa e kontributi në arsimimin e thelluar e të avancuar që kanë si komponent dominant kërkimin.
2. IKSHS ka si mision gjithashtu hartimin dhe kryerjen e kërkimeve dhe të studimeve në fushat e aktivitetit fizik e sportiv, të lidhura me shëndetin, performancën fizike e sportive, edukimit fizik dhe aktiviteteve rekreative dhe kujdeset për të hapur fusha të reja kërkimesh e studimesh shkencore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit në fushën e sportit e edukimit lëvizor e rekreacionit;
3. Drejtimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e projekteve kërkimore brenda e ndërinstucionale dhe përfshirjen në programet e projektet ndërkombëtare në këto fusha.

Neni 6

Struktura dhe organizimi i IKSHS

1. Autoritetet dhe organet drejtuese të IKSHS-së

Autoritetet drejtuese:

- Drejtori
- Drejtuesi i njësisë bazë

Organe kolegjiale drejtuese:

- Asambleja e personelit akademik të Institutit të Kërkimit Shkencor
- Drejtoria

Organe të tjera kolegjiale:

- Komisione të Përhershme të IKSHS-së

2. Njësitë bazë përbërëse të IKSHS:

- Departamenti i Performancës Sportive
- Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit
- Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë

3. Strukturat ndihmës-akademike me karakter administrativ të IKSHS:

- Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë
- Laboratorët Eksperimentalë
- Specialist/Asistent i Drejtorit

4. Strukturat ndihmës-akademike me karakter akademik në nivel njësie bazë:

- Specialistët/Laborantët

Neni 7

Organet dhe autoritetet drejtuese të IKSHS

Organet dhe autoritetet drejtuese të IKSHS janë:

1. Asambleja e personelit akademik të IKSHS si organi më i lartë vendim-marrës.
2. Drejtoria si organ kolegjal drejtues.
3. Autoritetet drejtuese akademike janë:
 - a. Drejtori
 - b. Drejtuesi i Departamentit.

Neni 8

Asambleja e Personelit Akademik të IKSHS

1. Asambleja (AIKSHS) është organi drejtues vendimmarrës në kuadër të IKSHS që përbëhet nga i gjithë personeli akademik me kohë të plotë i departamenteve të IKSHS.
2. Asambleja është organ kolegjal vendim-marrës, që programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve dhe drejtuesve, programet kërkimore të institutit, studimet dhe projektet kërkimore, veprimtarinë botuese e shkencore individuale dhe vendimmarrjen që lidhet me angazhimin në procesin mësimor të personelit të IKSHS në programet e studimit të UST.
3. Asambleja e IKSHS drejtohet nga Drejtori.
4. zgjedh Rektorin e UST-së, anëtarët përfaqësues të IKSHS në Senatin Akademik të UST-së dhe Drejtorin e IKSHS.

Neni 9

Funksionet dhe detyrat e Asamblesë të IKSHS

Asambleja e IKSHS-së kryen këto detyra:

1. Miraton dhe i propozon Senatit Akademik Planin Strategjik dhe planin vjetor të zhvillimit të Institutit;
2. Miraton dhe i propozon Senatit Akademik për hapje, ndryshim, riorganizim ose mbyllje departamentesh ose njësisish të tjera të tij;
3. Merr vendime dhe i paraqet Senatit Akademik propozime për projekte të kërkimit shkencor;
4. Diskuton e miraton, raportin vjetor të drejtorit për kërkimin shkencor, angazhimin në mësimdhënie të personelit të IKSHS dhe atë financiare të IKSHS;
5. Miraton dhe i propozon për miratim Senatit Akademik rregulloren e Institutit dhe aktet e tjera nënligjore të tij të parashikuara në Statutin dhe Rregullren e UST-së.

Neni 10

Drejtoria e IKSHS

1. Drejtoria është organ kolegjal ekzekutiv e cila koordinon të gjithë veprimtarinë e departamenteve në përbërje të IKSHS.
2. Drejtoria drejtohet nga Drejtori i IKSHS dhe përbëhet nga:
 - a. Drejtori;
 - b. Zëvendësdrejtori;
 - c. Drejtuesit e Departamenteve.
3. Funksionet e përgjithshme të Drejtorisë së IKSHS-së përcaktohen në Statutin dhe në Rregulloren e Përgjithëshme të UST-së.
4. Marrëdhëniet mes anëtarëve në Drejtorinë e IKSHS-së përcaktohen në këtë rregullore.
5. Funksionet e veçanta të Drejtorisë së IKSHS-së janë:
 - a. Harton planin strategjik të zhvillimit të IKSHS, mbështetur në propozimet e departamenteve të tij dhe ja paraqet për miratim asamblesë së IKSHS;

- b. Harton planin vjetor të veprimtarive të IKSHS, si dhe ndjek zbatimin e tij;
- c. Harton kërkesat buxhetore për financimin e veprimtarive të IKSHS, planin e investimeve dhe i paraqet ato për miratim në organet drejtuese të UST-së;
- d. Në bashkëpunim me departamentet përgatit dhe i paraqet organeve dhe autoriteteve drejtuese të UST-së, propozime për projekte dhe studime kërkimore, propozime për ndryshimet e nevojshme strukturore, etj;
- e. Formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore sipas njësive bazë të institutit;
- f. Shqyrton e miraton në një mbledhje të hapur me personelin akademik, ndihmës-akademik, administrativ, raportin vjetor të Drejtorit për veprimtarinë e IKSHS;
- g. Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të IKSHS;
- h. Propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Institutit për të gjitha nivelet duke u bazuar në ngarkesën vjetore sipas veprimtarive;
- i. Raporton një herë në vit në asamblenë e personelit akademike të IKSHS.

Neni 11 Drejtori

1. Drejtori është autoriteti më i lartë akademik dhe përfaqësuesi i IKSHS-së.
2. Ai është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit ose dhe jashtë tij.
3. Drejtori zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të institutit dhe emërohet nga rektori i UST-së.
4. Mandati i Drejtorit të IKSHS-së zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësive bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
5. Drejtori kryeson asamblenë e personelit akademik të njësive kryesore.
6. Drejtori kryen këto funksione:
 - a. Koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve të njësive kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
 - b. Përgatit propozimin përkatës për çdo vendimmarrje të njësive bazë;
 - c. Përgjigjet para Senatit Akademik për mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj;
 - d. I propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësive bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit;
 - e. I propozon rektorit ngritjen dhe përbërjen e komisionit *ad hoc* për procedurën e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës-akademik në njësinë përkatëse;
 - f. Kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në Statutin e UST-së.
7. Drejtori mban përgjegjësi direkte lidhur me veprimtaritë si vijon:
 - a. Veprimtarinë kërkimore-shkencore të institutit;
 - b. Organizimin e veprimtarive shkencore dhe promovuese;
 - c. Administrimin e rregullt të dokumentacionit kerkimor dhe shkencor;
 - d. Zbatimin e programit kerkimor-shkencor vjetor të institutit;
 - e. Disiplinimin e punës nga ana e personelit akademik dhe ndihmësakademik;
 - f. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së veprimtarisë së institutit;
 - g. Çështje të tjera të lidhura drejtperdrejt apo terthorazi me procesin e akreditimit;
 - h. Drejton dhe koordinon veprimtarinë shkencore të IKSHS;
 - i. Kujdeset, krijon mundësitë përfshirjen e projekteve shkencore në procesin e mësimdhënies në bashkëpunim me njesitë e tjera kryesore;
 - j. Bashkërendon dhe menaxhon veprimtarinë e personelit ndihmës-akademik të lidhur me laboratorët në nivel institucioni;

- k. Drejton punën për përditësimin e informacionit përkatës dhe editimin e tij në faqen zyrtare të universitetit;
8. Drejtori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe/ose udhëzime, të cilat bëhen publike bazuar në Ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
9. Kompetenca të tjera të drejtorit, marrëdhënieve të tij me strukturat e tjera në nivel Instituti parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të UST-së.

Neni 12

Zëvendësdrejtori

1. Zëvendësdrejtori është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i emëruar nga Drejtori pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Drejtori.
2. Zëvendësdrejtori emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori dhe me pëlqimin e Drejtorisë.
3. Numri i zëvendësdrejtorëve të një njësie kryesore propozohet nga Drejtori në varësi të problematikave dhe volumit të punës së tyre në IKSHS dhe pas miratimit në Senatin Akademik, vendimi i kalon për miratim edhe Bordit të Administrimit.
4. Zëvendësdrejtori ndjek dhe zbaton detyrat sipas fushës që mbulon. Fushat përcaktohen nga Drejtori.
5. Ai ushtron veprimtarinë e tij nën autoritetin e deleguar të Drejtorit të IKSHS-së.
6. Në mungesë e me porosi të Drejtorit, Zëvendësdrejtori nënshkruan aktet përkatëse me natyrë akademike dhe administrative që lejohen të delegohen për nënshkrim.
7. Zëvendësdrejtori ka detyrimin të marrë në vijimësi urdhra dhe orientime nga Drejtori i institutit, dhe të kryejë veprime me autorizim të tij në përmbushje të detyrave që i janë ngarkuar, sipas fushës që mbulon.
8. Zëvendësdrejtori ka të drejtë të marrë pjesë, të paraqesë mendime dhe rekomandime, të bëjë propozime në të gjitha mbledhjet e Drejtorisë, apo në struktura të tjera të IKSHS-së, vetëm për fushën që i është ngarkuar, apo deleguar nën përgjegjësi.
9. Zëvendësdrejtori nuk ndërmerr asnjë nismë akademike apo administrative pa u konsultuar dhe marrë më parë pëlqimin e Drejtorit të institutit.
10. Drejtori i IKSHS-së përcakton përkrahimin e punës të çdo zëvendësdrejtori për fushën që mbulon, duke bërë një ndarje të përgjegjësisë dhe marrëdhënieve të tyre me organet e tjera drejtuese dhe vartëse të universitetit.
11. Të gjitha strukturat e institutit kanë detyrimin t’i përgjigjen në kohë dhe me përgjegjësi porosive, urdhrave dhe orientimeve të zëvendësdrejtorit kur ato janë në ushtrim të rregullt me detyrat e ngarkuara të cilat kanë dhe shprehin vullnetin dhe autoritetin e deleguar të Drejtorit të Institutit.

Neni 13

Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është autoriteti drejtues akademik dhe përfaqësues i saj. Ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë, dhe është personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.
2. Drejtuesi i njësisë bazë emërohet nga drejtuesi i njësisë kryesore perkatëse. Ai mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
3. Drejtuesi i njësisë bazë kryen këto funksione:
 - a. Drejton punën për hartimin e planit kërkimor dhe projekteve në zbatim të tij dhe ndjek zbatimin e tyre;

- b. Mbikëqyr veprimtaritë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e veprimtarisë kërkimore të personelit akademik të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij;
 - c. I propozon Drejtorisë kriteret e posaçme të punësimit të personelit akademik për departamentin, pas miratimit në departament;
 - d. Mbikëqyr realizimin e veprimtarive vjetore të personelit akademik përkatës;
 - e. Organizon analiza periodike për raste e aspekte të veçanta në departament dhe analizën vjetore të punës mësimore shkencore të tij;
 - f. I propozon dekanit përkatës kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të fakultetit përkatës;
 - g. Ngre dhe drejton grupin e punës për hartimin e rregullores së njësisë bazë;
 - h. Në emër të departamentit bën përpjekje të vazhdueshme për krijimin e lidhjeve me institucione homologe dhe për promovimin e departamentit;
 - i. Bën të njohur arritjet e departamentit nëpërmjet nxitjes së botimeve informative e shkencore, përfshirjes ose bashkëpunimit në projekte, etj.
 - j. Kryen çdo funksion tjetër të parashikuar në Statutin e UST-së.
4. Mandati i përgjegjësit të zgjedhur, të njësisë bazë, mbaron para kohe në rastet:
- a. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b. kur jep dorëheqjen;
 - c. e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - d. e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - e. kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
 - f. kur largohet nga universiteti;
 - g. kur përfiton lejen sabatike.
5. Referuar Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Drejtori i propozon Rektorit shkarkimin e përgjegjësit të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UST-së. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i përgjegjësit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e dekanit të njësisë kryesore përkatëse. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

Neni 14

Drejtuesi i Grupit Kërkimor dhe Mësimor

1. Drejtuesi i grupit kërkimor dhe mësimor përzgjidhet me konkurs sipas përcaktimeve të Statutit të UST- së. Drejtori I Institutit emëron përgjegjësin e grupit mësimor e kërkimor pas konkurimit të hapur mes anëtarëve të njësisë bazë përkatëse.
2. Detyrat e tij përcaktohen në Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Rregulloren e UST-së:
 - a. Mbikqyr procesin kërkimor të grupit që drejton dhe i bën raport vjetor drejtuesit të njësisë bazë për realizimin e tij, duke pasqyruar dhe mendimin e grupit kërkimor.
 - b. Drejton dhe ndjek veprimtarinë shkencore të anëtarëve të grupit mësimor dhe kërkimor dhe informon rregullisht në njësinë bazë. Organizon analizën vjetore të kësaj pune në grup dhe depoziton në departament dokumentacionin e veprimtarisë shkencore të secilit anëtar.
 - c. Përgatit informacione për probleme pune të ngarkuara nga drejtuesi i njësisë bazë.
3. Mandati i drejtuesit të zgjedhur të grupit kërkimor-mësimor, mbaron para kohe në rastet:

- a. kur nuk kryen funksionin dhe detyrat e ngarkuara
- b. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c. kur jep dorëheqjen;
- d. e pamundësisë për të kryer detyrën;
- e. e shkeljeve të rënda të ligjit;
- f. kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
- g. kur grupi i ngritur për qëllime kërkimore-mësimore shkrihet;
- h. kur largohet nga universiteti;
- i. kur përfiton lejen sabatike.

Neni 15

Raportimi Vjetor i IKSHS

1. Për çdo vit akademik, IKShS paraqet pranë Rektoratit të UST-së Raportin Vjetor të Veprimtarisë së IKSHS për vitin përkatës.
2. Raportimi synon:
 - a. Të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së IKSHS në zbatim të misionit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - b. Të ofrojë informacion për angazhimin e personelit akademik në veprimtaritë e parashikuara kërkimore, didaktike, institucionale e administative;
 - c. Të nxitë dhe të rritë përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve të ofruara;
 - d. Të paraqesë problemet e konstatuara nga çdo njësi e IKSHS me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat e tjera të UST-së.
3. Raporti vjetor hartohet nga Instituti në 1 (një) kopje origjinale në formë të shkruar dhe elektronike cili i dërgohet Rektoratit të UST-së, brenda muajit tetor të çdo viti.
 - a. Drejtorja është përgjegjëse për hartimin e raportit të vjetor dhe paraqitjen e tij brenda datës të përcaktuar në udhëzimin përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 - b. Pas raportimeve të bëra nga njësitë bazë, përgatitet raporti vjetor përfundimtar nga Drejtori ku përfshihen e trajtohen çështjet si më poshtë:
 - c. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit dhe veprimtaritë në kuadër të kontributit e bashkëpunimit për realizimin e programeve të studimit të ofruara nga fakultetet e UST.
 - d. Raporte të vlerësimit të kërkimit shkencor dhe të gjitha veprimtarive të tjera të kryera nga IKSHS përgjatë përiudhës që mbulon raportin
 - e. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të Institutit.
 - f. Informacion mbi bashkëpunime ndër-institucionale dhe projekte ku merr pjesë IKSHS ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.
 - g. Informacion mbi kërkimin shkencor në IKSHS ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive dhe bashkëpunuese.
 - h. Të dhëna mbi lidhjet e kërkimit shkencor në kuadër të programeve të studimit me komponentë të rëndësishëm kërkimor;
 - i. Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi

- bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;
- j. Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor dhe laboratorëve kërkimorë-didaktikë që administrohen nga IKSHS.
 - k. Të dhëna mbi administrimin e Revistës Shkencore të UST dhe statistika mbi publikimet, konferencat e organizuara dhe të tjera që lidhen me funksionet e IKSHS në kuadër të UST.

KREU III

VEPRIMTARITË, FUNKSIONET DHE DETYRAT E IKSHS

Neni 16

Veprimtaritë e IKSHS

Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit kryen veprimtari kërkimore-shkencore, zhvillimi dhe inovacioni. IKSHS mbështet dhe bashkëpunon gjithashtu për realizimin e programeve të studimit që ofrohen nga fakultetet e UST.

Veprimtaritë e IKSHS-së janë:

1. Kërkimi shkencor bazë dhe i zbatuar
2. Kërkimi dhe studimi në fushat e aktivitetit fizik, sportiv, të lidhura me shëndetin, organizimin dhe menazhimin në sport, rehabilitimin, performancën fizike e sportive, edukimin fizik dhe aktivitete rekreative;
3. Kontributin dhe bashkëpunimin në kuadër të UST për formimin universitar të studentëve;
4. Shërbime për të tretë dhe transferim të njohurive e teknologjive të avancuara në fushat sportit, edukimit fizik, veprimtarisë fizike, rekreacionit e rehabilitimit përmes lëvizjes;
5. Planifikimi dhe realizimi i projekteve kërkimore dhe kesperizë shkencore brenda dhe jashtë IKSHS dhe UST;
6. Nxitjen dhe mbështetjeje e nismave shkencore individuale dhe kolektive të studjuesve të tij, por edhe të studentëve ekselentë për ta bërë më efikase veprimtarinë kërkimore-shkencore.
7. Të ushtrojë të drejtën për të lidhura marrëveshje me njësi kryesorë të IAL-ve të tjera, vendase ose të huaja, institucione kërkimore-shkencore e organizata profesionale sportive kombëtare e ndërkombëtare për realizimin e planit dhe projekteve kërkimore e profesionale.
8. Të ushtrojë të drejtën të planifikojë financimin e projekteve kërkimore dhe ta paraqesë atë për miratim në autoritetet/organet drejtuese vendim-marrëse të UST.

Neni 17

Kërkimi shkencor në IKSHS – Fushat kërkimore

Në të gjithë veprimtarinë e saj IKSHS mbështetet në parimin e lirisë akademike e kërkimore. Parimet udhëheqëse në këtë veprimtari janë e vërteta shkencore, e dokumentuar shkencërisht mbi bazën e të dhënave, fakteve reale dhe të verifikueshme, dhe/ose e formuluar mbi bazën e konkluzioneve logjike shkencore. Arritjet e veprimtarisë kërkimore-shkencore të IKSHS dhe produktet e rezultatet e kësaj veprimtarie vihen në shërbim të Sistemit Sportv Shqiptar, të shoqërisë në tërësi, në shërbim të zhvillimit të mëtejshëm të institucionit, si dhe në shërbim të kualifikimit të vazhdueshëm të punonjësve shkencorë e të studentëve.

Në veprimtarinë, studimet dhe rezultatet shkencore të saj garantohet dhe mbrohet liria e opinionit dhe e ideve, si kusht themelor për zhvillimin e mendimit kritik e krijues, në kërkimin shkencor dhe në formimin e thelluar, në përputhje me misionin e platformat kërkimore të IKSHS, në kuadër dhe brenda strategjisë e planit të kërkimit të UST.

Fushat kryesore të kërkimit që lëvrohen në kuadër të veprimtarisë kërkimore të IKSHS janë:

1. Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti
2. Biologjia e aplikuar ne aktivitetin fizik
3. Aktiviteti fizik i adaptuar
4. Neuroshkenca dhe levizja
5. Biomekanika dhe analiza e levizjes
6. Fiziologjia e ushtrimit
7. Edukimi Fizik dhe Shëndeti
8. Edukimi fizik i adaptuar
9. Edukimi fizik, pedagogjia dhe didaktika
10. Rekreacioni, Sporti dhe Turizmi
11. Menaxhimi, legjislacioni në aktivitetin fizik, sport dhe turizem
12. Trajnimi dhe psikologjia e Sportit
13. Psikologjia e shëndetit dhe sjelljes
14. Rehabilitimi përmes lëvizjes
15. Aspekte Social-kulturore dhe historike që lidhen më Aktivitetin Fizik dhe Sportin

Neni 18

Funksionet e IKSHS

1. Bashkërendon, bashkëpunon e udhëheq projekte kërkimore brenda e ndërinstucionale dhe përfshihet në projekte ndërkombëtare në këto fusha.
2. Kujdeset për përhapjen e dijeve dhe të vlerave të kërkimit shkencor, nëpërmjet mediatizimit të tyre, si dhe nëpërmjet formave të tjera të transmetimit të informacionit;
3. Bashkëpunon me fakultetet e UST për formimin universitar dhe pasuniversitar në fusha e programe studimi me komponent të fuqishëm kërkimor, Master Shkencor, Master Ekzekutiv dhe Doktoratë.
4. Vlerëson e bën të njohur impaktin e studimeve, kërkimeve në zhvillimin në e sportit elitare, në edukimin për lëvizjen dhe masivizimin e sportit në komunitete, në ndërgjegjësimin dhe ndikimin të shëndetit publik dhe në politikat lokale e kombëtare në këto fusha.
5. Kujdeset e krijon kushte të përshtatshme për kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të institucionit dhe programon, planifikon, motivon e nxit veprimtarinë e tyre për mbrojtjen dhe fitimin e titujve shkencorë sipas dispozitave ligjore.
6. Bashkëpunon me njësitë e tjera për kualifikimin e personelit dhe stafit akademik dhe specialistëve të fushës për kualifikimin në fushat e veprimtarisë fizike e rekreative, të drejtmeve kërkimore të aplikuara në aktivitet fizik e sport.
7. Bashkëpunon me institucione homologe, me universitete dhe me qendra të tjera shkencore, publike e private, vendore, rajonale e ndërkombëtare, me synimin për të forcuar impaktin shkencor, kulturor, shoqëror dhe edukativ të sportit dhe lëvizjes në përgjithësi.
8. Harton dhe publikon studime shkencore në formën e përmbledhjeve shkencore, artikujve kërkimorë, monografive e rasteve studimore dhe i bën ato publike përmes formave mediatike, revistave e periodikëve.
9. Administron dhe menaxhon funksionimin dhe veprimtarinë botuese të Revistës Shkencore të UST, në përputhje me aktet përkatëse rregullative të UST.
10. Administron dhe menaxhon në mënyrë të integruar Laboratorët Eksperimentalë të UST, në përputhje me aktet përkatëse rregullative të UST.

Neni 19

Veprimtaritë kërkimore të IKSHS në kuadër të UST

1. Kërkimi shkencor, bazë dhe i aplikuar, me interes të gjerë për rajonin, është veprimtari që ndërmerret për të përmbushur misionin e njërive për kërkim shkencor, sipas standardeve bashkëkohore. Këto studime duhet të synojnë ritmet e zhvillimit teorik bashkëkohor, në koherencë me arritjet në fushat përkatëse, brenda dhe jashtë vendit. Kërkimi shkencor shoqërohet me rinovime teknologjike në fushën analitike, të përpunimit të informacionit etj., për të garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e tyre. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative në IKSHS është pjesë integrale e projektbuxhetit të UST-së për çdo vit pasardhës.
2. Forma kryesore e realizimit të veprimtarisë kërkimore është projekti. Punonjësit kërkimorë shkencorë të profileve të ndryshme, brenda dhe jashtë njërive bazë të IKSHS. Ata kane lirinë akademike të garantuar që të grupohen, të hartojnë projekte në përputhje me fushat e kërkimit shkencor dhe programet publike të zhvillimit të vendit apo sektorëve të veçantë, të ndjekin procedurat e caktuara për shqyrtimin e miratimin e projekteve dhe pas miratimit, të vihen në dispozicion të zbatimit të tyre në kohë e me cilësinë e kërkuar.
3. Për hartimin e projektpropozimeve për projekte të kërkimit shkencor apo veprimtari të tjera të lidhura me kërkimin shkencor për të cilat kërkohet mbështetja dhe financimi nga buxheti i UST-së, ndiqet procedura e miratuar sipas akteve rregullative në UST duke aplikuar sipas formatit standard të miratuar në organet drejtuese vendim-marrëse të institucionit.
4. Në kuadër të UST, IKSHS kryen shërbime për të tretë si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari shkojnë në favor të buxhetit të UST-së.
5. Masa e shpërbimit të personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, përcaktohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Grupi i koordinimit të kërkimit shkencor brenda njësisë bazë të fakulteteve dhe njësia e ngarkuar për menaxhimin dhe koordinimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në institutin e kërkimit, janë përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së artikujve të propozuar për botim në numrin përkatës të revistës “Buletini Shkencor”.
7. Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë është përgjegjës për redaktimin gjuhësor të artikujve të vlerësuar për botim në numrin përkatës të revistës “Buletini Shkencor”, si dhe për çështje të tjera të karakterit teknik, me qëllim plotësimin e standardeve të kërkuara për një botim shkencor.
8. Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë është përgjegjës për respektimin e afateve të përcaktuara për botimin e numrit përkatës të revistës “Buletini shkencor”, si dhe për dorëzimin e kopjes që i takon çdo artikullshkruesi.
9. Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë në IKSHS është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e veprimtarisë botuese të Revistës Shkencore të UST dhe administrimit e mbarëvajtjes së Laboratorëve Kërkimorë në funksion të realizimit të projekteve kërkimore në kuadër të UST.

Neni 20

Kërkimi shkencor në IKSHS

1. IKSHS në kuadër të UST-së dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, kryen veprimtari kërkimore-shkencore, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese e të inovacionit.
2. Kërkimi në IKSHS zhvillohet në zbatim të Planit Strategjik të tij. Plani Strategjik

- zërthehet në objektiva strategjike, për të cilët parashikohen masa veprimi dhe rezultate të pritshme, që përkohet me treguesit e arritjeve dhe shoqërohet me planin e veprimit ku përcaktohen afatet, subjektet përgjegjëse dhe kostoja financiare për ato veprimtari që parashikojnë efekte financiare.
- IKSHS harton planin afatmesëm të zhvillimit të tij. Mbështetur në planin e zhvillimit hartohen programet vjetore të veprimtarisë së njësisë bazë, duke caktuar e vendosur raporte të drejta ndërmjet kërkimit shkencor, angazhimit në mësimdhënie dhe veprimtarive të tjera, në përputhje me misionin që ato kanë. Plani i zhvillimit paraqitet në Rektorat dhe miratohet në Senatin Akademik.
 - Njësia bazë, mbështetur në propozimet e asamblesë së saj akademike, si dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, përcakton fushat bazë të kërkimit në departament, si dhe prioritetet e kërkimit shkencor në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.
 - Mbështetur dhe në përputhje me fushat prioritare kërkimore të UST dhe të saj, IKSHS harton programin vjetor të veprimtarisë së tij, plan i cili, pasi miratohet në Asamblesën e IKSHS paraqitet në Rektorat dhe miratohet në Senatin Akademik. Në zbatim të tij, IKSHS përcakton temat dhe afatet e kërkimit, drejtimet programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, si dhe burimet financiare në dispozicion.
 - Njësia bazë, mbështetur në propozimet e asamblesë së saj akademike, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, përcakton fushat bazë të kërkimit në departament, si dhe prioritetet e kërkimit shkencor në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.
 - Instituti i Kërkimit Shkencor harton planin vjetor të kërkimit brenda muajit Tetor të çdo viti akademik, mbështetur në propozimet nga njësitë bazë. Këto të fundit pasqyrohen në marrëveshjet individuale të punës së cdo antari të personelit akademik të IKSHS.
 - Produktet e kërkimit paraqiten e bëhen të njohura përmes aktiviteteve të ndryshme shkencore si konferencat, simpoziumet, seminarët, kongreset, takimet, konsultat dhe trajnimet shkencore që koordinohen nga IKSHS në kuadër të UST e që lidhen drejtpërdrejt me kërkimin shkencor.
 - IKSHS shfrytëzon të gjitha mjetet dhe hapësirat në UST për të siguruar vlerësimin, promovimin dhe mediatizimin e rezultateve të veta shkencore përmes veprimtarive shkencore, si dhe përmes formave të njohura të marketingut shkencor e kulturor.
 - Veprimtaria kërkimore-shkencore në IKSHS kryhet në përputhje edhe me aktet rregullatore për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese.

Neni 21

Projektet kërkimore

- IKSHS e zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të programeve kërkimore e të projekteve shkencore vjetore dhe shumëvjeçare. Projektet hartohen në fillim të cdo viti akademik dhe, pasi diskutohen, miratohen në strukturat vendimmarrëse të IKSHS.
- Projektet kërkimore hartohen në përputhje me objektivat zhvillimore të UST si dhe me projekte madhore kombëtare apo ndërkombëtare të fushës. Projektet në rang institucional, hartohen si produkt i projekteve që propozohen nga departamenti, individuale ose grupe, në bazën e udhëzimeve mbi drejtimet kryesore kërkimore institucionale dhe brenda mundësive financiare të vena në dispozicion për periudhën e përcaktuar.
- Projektet kërkimore, të klasifikuara sipas përgjegjësive individuale, bëhen pjesë e kontratës shkencore individuale vjetore të personelit kërkimor në parashikimin vjetor dhe në llogaridhënie në përfundim të vitit akademik. Për projektet disa vjeçare, raportimi bëhet në disa faza si i pjesshëm dhe përfundimtar në fund të periudhës së parashikuar.
- Për realizimin e projekteve kërkimore, IKSHS bashkëpunon me njësitë e tjera kryesore të UST, me universitete dhe me institucione të tjera të arsimit të lartë të vendit, duke synuar

integrimin sa më efektiv të punës kërkimore brenda universitetit, por edhe në shkallë kombëtare kur është e mundur. Ky bashkëpunim kryhet në bazë të marrëveshjeve institucionale dhe / ose individuale, për të realizuar pjesëmarrjen e punonjësve shkencorë në procesin mësimor, përfshirjen e tyre në projekte e programe të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe shfrytëzimin e ndërsjellë të arkivave, bibliotekave dhe pajisjeve e laboratorëve shkencorë.

5. IKSHS vendos dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi dhe realizon projekte me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federata Sportive Kombëtare e Ndërkombëtare si dhe organizata të dedikuara në fushën e sportit, aktivitetit fizik, shëndetit, rekreacionit dhe turizmit.
6. IKSHS vendos dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe universitare rajonale e ndërkombëtare, për integrimin sa më të frytshëm dhe kontributin e kërkimit shkencor shqiptar në atë ndërkombëtar.

Neni 22

Departamentet si njësi bazë kërkimore të IKSHS

1. Departamenti është njësi bazë për organizimin dhe realizimin e kërkimit shkencor dhe të formimit akademik në fushat e mbuluara nga programi shkencor i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit. Në një departament përfshihen fusha kërkimi homogjene ose të ngjashme, në përputhje dhe në zbatim të fushave të kërkimit të përcaktuara e miratuara në rang të UST dhe IKSHS.
2. Departamentet nxitin, bashkërendojnë, zhvillojnë, organizojnë dhe administrojnë veprimtaritë kërkimore të kombinuara edhe me ato të mësimdhënies sipas planit të miratuar nga ansambleja e departamentit.,
3. Menaxhojnë fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera projektsh, që departamenti gjeneron nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit sipas akteve ligjore e nënligjore të disiplinës financiare në fuqi.
4. Departamentet e IKSHS ofrojnë shërbime për të tretë, si dhe zhvillojnë veprimtari të tjera, sipas legjislationit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të UST-së.
5. Sipas nevojave të kërkimit dhe intucionit, departamentet mund të organizohet brenda tyre edhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor. Titullarët e grupeve duhet të kenë, së paku, gradën shkencore “Doktor” dhe përzgjidhen me konkurim të hapur. Procedurat që ndiqen për këtë qëllim mbështeten në përcaktimet ligjore, në statutin dhe rregulloren e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Titullarët e grupeve me pas emërohen nga Drejtori për një periudhë 4 vjecare.
6. Fusha e kërkimit shkencor, dhe struktura organizative e departamenteve të institutit përcaktohen në këtë rregullore dhe në rregulloret përkatëse të njësisive bazë të IKSHS.

Neni 23

Njësitë bazë të IKSHS: fushat e veprimtarisë kërkimore dhe shkencore

Përveç detyrave dhe përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, njësitë e IKSHS kanë disa detyra e veprimtari kërkimore të veçanta, brenda të cilave përcaktojnë aktivitetin e tyre kërkimor, didaktik dhe të vecantë.

IKSHS organizohet në tri departamente me fushat kryesore përkatëse të veprimtarisë si më poshtë.

1. **Departamenti i Performancës Sportive** zhvillon veprimtarinë kërkimore në këto fusha e kryesore kërkimi:

- a. Hartimin dhe kryerjen projekteve e studimeve në fusha që lidhen me performancën sportive, sportet elitare individuale apo në grup;
- b. Faktorët që ndikojnë në performancën fizike e sportive;
- c. Treguesit fizikë, fiziologjikë, biokimikë e biomekanikë që shërbejnë për vlerësimin e persformancës, për vlerësimin e përshtatshmërisë së programeve ushtrimore e stërvitore tek sportistët elitare;
- d. Ndikimi në aspektin intelektual, psikologjik dhe social në performancën sportive;
- e. Orientimin e propozimin e programeve specifike që synojnë përmirësimin e treguesve të performancës në përputhje dhe me shëndetin e sportistit;
- f. Studime performative e monitoruese në vazhdimësi të sportistëve pjesëmarrës në aktivitete të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, me synim rritjen dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe;
- g. Kërkime në fusha të tjera që kanë të bëjnë me objektin kryesor të këtij departamenti/njësie e në përputhje me platformat institucionale të kërkimit.

Emërtimi zyrtar i Departamentit të Performancës Sportive në gjuhën angleze është **“Department of Sport Performance”**, dhe akronim **“DSP”**

2. Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit zhvillon veprimtarinë kërkimore në këto fusha kryesore kërkimi:

- a. Përfitimet shëndetësore të ndryshme e të shumëllojshme të Aktivitetit Fizik;
- b. Aktiviteti fizik në grupmosha të ndryshme;
- c. Moshimi dhe ndikimi i Aktivitetit Fizik në parandalimin dhe menaxhimin e proceseve të moshimit;
- d. Aktiviteti Fizik për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve kronike;
- e. Obeziteti përkundrejt sedentaritetit; roli i ushtrimit në parandalimin e tij;
- f. Efektet dhe ndikimi i aktivitetit fizik në shëndetin dhe performancën fizike e sportive;
- g. Përfitimet në aspektin intelektual, psikologjik dhe sociale të Aktivitetit Fizik;
- h. Promovimi i përfitimeve të Aktivitetit Fizik për shëndet të mirë dhe cilësi të jetës;
- i. Fusha të tjera kërkimore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sa më sipër.

Emërtimi zyrtar i Departamentit të Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit në gjuhën angleze është **“Department of Physical Activity and Health”**, dhe akronim **“DPAH”**.

3. Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë (DPT) zhvillon veprimtarinë kërkimore-studimore në këto fusha kryesore kërkimi:

- a. Hartimin, koordinimin e zhvillimin e projekteve në nivel njësisë, IKSHS dhe UST në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- b. Analiza dhe vlerësimin e gjendjes së tregut të punës në fushën e sportit, aktivitetit rekreativ dhe edukimit fizik, turizmit, legjislacionin ekzistues dhe përmirësimin e tij;
- c. Analiza dhe vlerësimi i praktikave ekzistuese menaxhuese të institucioneve e organizatave sportive, shëndetit dhe rehabilitimit si dhe turizmit;
- d. Kërkimin dhe studimin për nxitjen dhe promovimin e modeleve më efektive të drejtimit dhe menaxhimit të tyre;
- e. Studime që lidhen me njohuritë e reja, protokollet shkencore, teknologjitë e avancuara dhe përhapjen e tyre tek stafi akademik dhe studentët, brenda dhe jashtë institucionit e UST-së;
- f. Fusha të tjera që kanë të bëjnë me objektin kryesor të këtij departamenti e në përputhje me platformat digjitale institucionale të kërkimit dhe mësimdhënies.

Emërtimi zyrtar i Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë në gjuhën angleze është **“Department of Projects and Technology”**, dhe akronim **“DPT”**.

Neni 24

Kontributi i IKSHS në procesin mësimor të UST

1. Me statusin e Institutit të Kërkimit dhe Zhvillimit, sipas ligjit të arsimit të lartë, IKSHS, krahas veprimtarisë kërkimore-shkencore mund të kontribojë e bashkëpunojë me fakultetet e UST-së në konceptimin, hartimin e realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë e të tretë, që kanë si object kryesor studime të thelluara me një component të vecantë kërkimor, zhvillimor e inovativ.
2. Në këtë cilësi, IKSHS mund të bashkëpunojë ngushtë me fakultetet e UST-së për realizimin e programeve të thelluara të nivelit “Master Shkencor”, Maser Ekzekutiv dhe “Doktoratë” që ofrohen në UST, për drejtimin e kandidatëve Doktorantë dhe veprimtari të tjera specifike të parashikuara në kuadër të realizimit të këtyre programeve.
3. IKSHS, në bashkëpunim me fakultetet, mund të ofrojë gjithashtu kurse speciale kualifikimi në fusha të veçanta për trainerë, mësuesit e edukimit fizik, mësuesit e shkencave të shëndetit, menaxheret e njësisive të sporteve rekreacionale si dhe menaxhere e guida të njësisive turisike, punonjësit e institucioneve sportive shtetërore apo private, apo kurse përditësimi të thelluara të tjera që kanë për qëllim përditësimin e dijeve, të metodave dhe të mjeteve didaktike e shkencore që forcojnë procesin e mësimdhënies, apo promovimin e sportit dhe aktivitetit fizik për shëndet dhe rehabilitim, si dhe për persormancën sportive.
4. IKSHS mund të kontribojë e bashkëpunojë për ofrimin e programeve të thelluara studimi për disiplina të veçanta, ose programe të thelluara e me natyrë ndërdisiplinore, që kanë për qëllim ngritjen e nivelit shkencor të doktorantëve të rinj dhe të stafit akademik të universiteteve.
5. Procedurat dhe kriteret për përfshirjen e IKSHS dhe personelit të saj akedemik në veprimtari të karakterit didaktik e të mësim dhenies kryhen në përputhje të plotë me parashikimet ligjore në përgjithësi për këto programe studimi dhe më në veçanti me përcaktimet në statutin dhe rregulloren e UST, dhe Rregulloret e Njësisive Kryesore përbërëse.

Neni 25

Shërbimet e IKSHS për të tretë

1. Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit mund tu ofrojë palëve të ndryshme jashtë UST, një sërë shërbimesh që përfshijnë:
 - a. Shërbime, teste apo analiza të posacme e specifike që lidhen me fushat apo drejtimet në të cilat IKSHS operon;
 - b. Të kërkojë ose pranojë oferta për kërkime shkencore të porositura në shërbim të palëve të ineteresuara publike ose private;
 - c. Të ofrojë, ekspertizë shkencore e shërbime të tjera që lidhen me fushat e kespërtizës së personeit të saj e që janë brenda fusës së operativitetit të IKSHS;
 - d. Të hartojë materiale informuese shkencore e para-shkencore për institucione shtetërore apo private të interesuara;
2. Tarifat e rregullat për ofrimin e këtyre shërbimeve propozohen nga IKSHS miratohen në Rektorat, Senat dhe Bordin e Administrimit të UST-së.
3. Të ardhurat e përfutuara nga këto shërbime ndahen dhe përdoren sipas marrëveshjes së posacme të lidhura paraprakisht, në përputhje me rregullat financiare të secilit institucion dhe me aktet ligjore e nënligjore te disipline financiare në fuqi.

Neni 26

Laboratorët kërkimorë të IKSHS

Pranë IKSHS funksionojnë tre laboratorë eksperimentalë-kërkimorë:

- a. Laboratori i Biologjisë, Biokimisë dhe Gjenetikës së Ushtrimit
- b. Laboratori i Fiziologjisë së Ushtrimit
- c. Laboratori i Biomekanikës

Këta laboratorë administrohen në cilësinë dhe me statusin e njërive ndihmëse të UST, nën përgjegjësinë e IKSHS përmes Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë.

Neni 27

Shërbimet dhe funksioni i laboratorëve kërkimorë

Laboratorët eksperimentalë-kërkimorë shërbejnë për kryerjen e studimeve e kërkimeve në fushat kërkimore të IKSHS e UST-së, për realizimin e programeve kërkimore e projekteve të miratuara nga organet vendimmarrëse të njërive kryesore e UST.

- a. Laboratorët shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë eksperimentale të programeve kërkimore të studentëve të programit të Doktoratës në UST.
- b. Në këta laboratorë kryhen gjithashtu testime e analiza në shërbim të studimeve e projekteve në bashkëpunim me njësitë e tjera kryesore në UST, apo me institucione të tjera vendase e të huaja.
- c. Në laboratorët kërkimorë mund të kryehen edhe seanca të veçanta demonstruese me studentë të kurseve të avancuara të studimit që kanë në objektin e formimit Biologjinë, Biomekanikën, Analizën e Lëvizjes dhe Fiziologjinë e Ushtrimit.
- d. Laboratorët kërkimorë mund të ofrojnë dhe shërbime për të tretë, në përputhje me rregulloren specifike të funksionimit të tyre dhe përkundrejt tarifave të përcaktuara nga Senati dhe Këshilli i Administrimit të UST.

Neni 28

Administrimi dhe rregullat e funksionimit e përdorimit të laboratorëve

1. Laboratorët administrohen nën përgjegjësinë e personave të ngarkuar si me poshtë:
 - a. Një anëtar i personelit akademik që përzgjidhet mes punonjësve dhe specialistëve të Departamentit të Projekteve dhe Teknologjisë të IKSHS, në bazë të nivelit arsimor, aftësive profesionale dhe përputhshmërisë së formimit dhe specializimit të tyre me objektin dhe natyrën specifike të fushës së aplikimit të laboratorëve.
 - b. Specialisti/laboranti i secilit laborator përkatës - (personel ndihmës-kërkimor).
2. Personeli akademik përgjegjës i laboratorit i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë Drejtorit në lidhje me mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e laboratorit duke garantur e certifikuar zyrtarisht cilësinë e rezultateve shkencore laboratorike.
3. Laboratorët ndodhen në mjedise të veçanta e të veçuara të UST-së, ku kryejnë veprimtarinë vetëm personat përgjegjës si më sipër.
4. Personat e tjerë të paautorizuar, mund të frekuentojnë dhe/ose përdorin laboratorët vetëm kur janë autorë, bashkëpunorë të kërkimeve që kryhen, dhe në çdo rast me kërkesë të argumentuar tek drejtuesi i departamentit i cili ja percjell Drejtorit të IKSHS për të leshuar autorizimin e venien në dispozicion të laboratorit dhe personave që kanë në përgjegjësi administrimin dhe funksionimin e tijë.
5. Kushtet e sigurisë, higjenës dhe standarteve të tjera specifike sigurohen sipas standarteve më të mira të cilësisë dhe kuadrit legjislativ në fuqi rreth tyre dhe çertifikohen nga institucionet shtetërore që kontrollojnë e çertifikojnë këto standarde.
6. Nëse personat përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin dhe funksionimin e laboratorit, konstatojnë që për shkaqe të përligjura laboratori nuk i plotëson këto standarde, hartojnë me shkrim një raport të detajuar për Drejtorin e IKSHS.
7. Për administrimin dhe rregullat e veçanta të funksionimit dhe përdorimit të laboratorëve, Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë harton një rregullore specifike, e cila shqyrtohet në Asambleenë IKSHS-së e cila miratohet nga Rektori i UST.

KREU IV PERSONELI I IKSHS

Neni 29

Kategoritë e personelit të IKSHS

1. Personeli në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës-akademik dhe personeli administrativ.
2. Personeli në IKSHS është i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, sipas Statutit, Rregullores së përgjithshme dhe Rregullores së Rekrutimeve në UST-së ku përcaktohen procedurat dhe kushtet për lidhjen e kontratave me punonjësit sipas çdo kategorie specifike të punësimit.
3. Personeli zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, Rregulloret e universitetit dhe të njëjve kryesore si dhe të gjitha akteve të tjera të brendshme të UST-së.
4. Të drejtat dhe detyrimet e personelit në IKSHS përcaktohen në Statut, në rregulloret e akte të tjera të brendshme të universitetit dhe/apo njësisë kryesore, si dhe në kontratat individuale të punës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 30

Kategoritë e personelit akademik të IKSHS

1. Personeli akademik IKSHS kryen veprimtari të kërkimit shkencor, të mbështetjes së mësimdhënies, shërbime për mbështetje dhe zhvillim Institutit, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera të cilat janë të përcaktuara në aktet rregullatore të UST dhe të pasqyruara në marrëveshjen e ngarkesës vjetore të punonjësit akademik.
2. Personeli akademik në IKSHS është me orientim kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe njësitë kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për personelit akademik përkatës dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.
3. Personeli akademik i IKSHS sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a. Profesorë;
 - b. Lektorë;
 - c. Asistent-lektorë.
4. Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.
5. Në kategorinë “Lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, kanë së paku tre vjet përvojë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UST-së.
6. Në kategorinë “Asistent-lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i shkencave” dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në Statutin, Rregulloren e përgjithshme dhe Rregulloren e Rekrutimeve të UST-së.
7. Personeli akademik i IKSHS, që angazhohet në mbështetje të aktiviteteve të mësimdhënies, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
8. Raportet midis veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen nga IKSHS sipas përcaktimeve në udhëzimet përkatëse të

ministrit përgjegjës për arsimin dhe akteve përkatëse të UST.

9. Ngarkesa e plotëvetore, e ndarë sipas veprimtarive kryesore për personelin akademik përcaktohet nga IKSHS në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin dhe aktet e UST.

Neni 31

Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik

1. Personeli akademik i IKSHS gëzon status dhe trajtim të veçantë, që konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësitë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre.
2. Personeli akademik gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij, në:
 - a. mësimdhënie;
 - b. punë kërkimore-shkencore;
 - c. kontribut institucional;
 - d. kontribut profesional.
3. Specifikime me te detajuara te kesaje lirie akademike jane te sanksionuara ne Statutin dhe Rregulloren e UST-së.

Neni 32

Punësimi i personelit akademik të IKSHS

1. Punësimi i personelit akademik bëhet me kohë të plotë, kohë të pjesshme, të ftuar apo përmes lëvizjeve paralele brenda dhe midis njësive bazë apo kryesore të UST-së. Këto kryhen duke u bazuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.
2. Punësimi i personelit akademik pavaresisht kohëzgjatjes dhe formës së punësimit realizohet përmes një procedure konkurrimi të hapur, në një proces transparent dhe të paanshëm. Kkriteret e përgjithshme dhe ato specifike të punësimit për të gjitha kategoritë e personelit akademik si dhe procedurat që ndiqen për të realizuar këtë punësim bëhen sipas përcaktimeve në Statutin, Rregulloren dhe Rregulloren e rekrutimeve të UST-së.
3. Për personelin kërkimor në IKSHS, përveç kriterëve të përgjithshme dhe akademike të përgjithshme të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore si dhe në Rregulloren e UST, përcaktohen kriteret specifike shtesë që lidhen me natyrën, shkallën e kualifikimit dhe ngarkesën e veçantë kërkimore që ky staf kërkohet të mbulojë me ligj të cilat hartohen rast pas rasti nga departamentet përkatëse ku hapet vendi i lirë i punës .

Neni 33

Të drejtat e personelit akademik të IKSHS

Personeli akademik i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit ka këto të drejta:

- a. Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- b. Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profilin;
- c. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e IKSHS dhe UST-së, duke kryer veprimtari zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret e tjera të institucionit;
- d. Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë ekzistuese në universitet, institut e departament, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
- e. Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, institutit, e universitetit, respektimin prej tyre të të gjitha të drejtave që u siguron atyre Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligjin "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Statutin e Rregulloren e UST-së dhe kuadrin rregullator ne fuqi.

Neni 34

Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik të IKSHS

Personeli akademik i IKSHS ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a. Të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b. Të respektojë kohën në funksion të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies sipas marreveshjes së punës akademiko-shkencore të vitit akademik. Koha e punës, kërkimit, mësimdhënies dhe të veprimtarive të tjera përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës dhe marreveshjes vjetore të personelit akademik;
- c. Të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;
- d. Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme të UST-së;
- e. Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në IKSHS;
- f. Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit dhe figurës profesionale;
- g. Të zbatojë kodin e etikës, gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike;
- h. Bazuar në Rregulloren e Programit të Digjitalizimit të Sistemit Universitar, personeli i IKSHS që angazhohet në mbështetje të mësimdhënies zbaton të gjitha detyrimet dhe ka përgjegjësi për plotësimin e tyre konform rregulloreve specifike të njesise baze apo kryesore ku është i angazhuar në mësimdhënie.

Neni 35

Personeli akademik i ftuar

1. Njësia bazë/IKSHS ka të drejtë të kërkojë të punësohen me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiu, personalitete, sportive vendas ose të huaj. Personeli i ftuar përbëhet kryesisht nga punonjës me tituj shkencorë.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet nga njësia kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë, pasi të jenë identifikuar projektet apo veprimtaritë ku do të angazhohen, detyrat që ata do të kryejnë, si dhe kualifikimi i kandidatëve.
3. Personel i ftuar kërkimor janë personalitete të shqura dhe me përvojë të spikatur ndërkombëtarisht në fushat kërkimore studimore që lëvron IKSHS.
4. Kontrata e punës e personelit akademik të ftuar bëhet nga rektori i UST-së.
5. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e universitetit sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 33

Veprimtaria që kryen personeli akademik i IKSHS

1. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IKSHS janë:
 - a. Kërkimi shkencor
 - b. Mësimdhënie
 - c. Kontribut institucional
 - d. Kontribut profesional
2. Kontributi në kërkimin shkencor përfshin:
 - a. Veprimtari kërkimore;
 - b. Pjesëmarrje në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konference, seminare, kongrese, workshope, veprimtari sportive në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, etj.;

- c. Publikim monografish, artikujsh apo punimesh shkencore të natyrave të ndryshme në periodikë apo serial botimesh shkencore (joperiodike) me komitet shkencor vlerësues dhe drejtues;
 - d. Pjesëmarrje në borde revistash shkencore apo serial botimesh shkencore (joperiodike) apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit;
 - e. Udhëheqje në programe doktorale, apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit etj.;
 - f. Përgatitja e projekteve dhe ndjekja e procesit të aplikimit në kuadër të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Mësimdhënia përfshin:
- a. Veprimtari në auditor si vijon:
 - i. Leksione
 - ii. Seminare
 - iii. Lëndë speciale
 - iv. Ushtrime
 - v. Laboratorë
 - vi. Projekte kursi
 - b. Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor si vijon:
 - i. Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale
 - ii. Konsultime/Këshillim studentësh
 - iii. Udhëheqje diplome ne te tre ciklet
 - iv. Kontroll i dijeve (provime, kolokuiume)
 - v. Përgatitje individuale
 - vi. Ekspozitë, garë dhe prezantime
 - vii. Recensë punimi diplome cikli i tretë i studimeve.
4. Kontributi institucional, përfshin veprimtarinë akademike dhe administrative në mbështetje të njësive bazë, njësive kryesore, institucionit dhe administratës publike, si vijon:
- a. Hartimi i programeve të studimit;
 - b. Hartimi i rregulloreve apo dokumentacioneve;
 - c. Përgatitje botimesh universitare;
 - d. Pjesëmarrje në komisionet *ad hoc*;
 - e. Pjesëmarrje në komisionet për hartimin dhe përgatitjen e proceseve akredituese të institucionit apo programeve të studimit;
 - f. Pjesëmarrje në veprimtarinë e organeve të njësisë bazë, të IKSHS dhe të UST- së.
 - g. Pjesëmarrje në grupe pune të ngritura nga institucione të administratës publike.
5. Kontributi profesional përfshin:
- a. Veprimtari për zhvillim dhe transferim teknologjie dhe/ose shërbime të tjera të lidhura me të;
 - b. Ekspertizë;
 - c. Përhapje të njohurive shkencore e teknologjike në mbështetje të mësimdhënies;
 - d. Angazhim në aktivitete sportive, rekreacionale dhe promovuese të shëndetit në lidhje me përfshirjen e studentëve;
 - e. Trajnim për transferime të teknologjisë, të shkencës dhe inovacionit në mësimdhënie;
 - f. Hartim projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - g. Angazhim si ekspert në grupe pune të ngritura me urdhër të Ministrit apo Kryeministrit, si dhe në nivel rajonal, bashkitë dhe qarqet administrative.

Neni 34

Ngarkesa kërkimore vjetore për personelin akademik të IKSHS

1. Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në IKSHS, duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë.

2. Personeli akademik i IKSHS është personel i kategorisë kërkimor-shkencor. Për këtë arsye veprimtaria që ze pjesën dërrmuese të ngarkesës së tij vjetore është kontributi që ai jep në Kërkimin Shkencor.
3. Kontributi në kërkimin shkencor përfshin, veprimtaritë e mirëfillta kërkimore në kuadër të projekteve të kërkimit, angazhimi e pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare, publikimet shkencore të llojeve të ndryshme, pjesëmarrja në borde e trupa shkencore, përgatitjen e projekteve ndërkombëtare, etj.konferenca, seminare, kongrese, ëorkshope, veprimtari sportive në aktivitete kombetare e ndërkombetare, etj.
4. Veprimtaria kërkimore zë rreth 70% (deri në 1000 orë) të ngarkesës vjetore të punës së personelit akademik të IKSHS, por në cdo rast sipas përcaktimeve në aktet e brendshme të UST.

Neni 35

Ngarkesa mësimore vjetore për angazhimin në mësimdhënies të personelit akademik të IKSHS

1. Ngarkesa mësimore vjetore e normuar për personelin akademik të IKSHS që angazhohet në mbështetje të mësimdhënies në kuadër të programeve të studimit të ofruar nga fakultetet e UST është sa 30% e ngarkesës së normuar sipas kategorisë të stafit akademik si dhe të autoriteteve drejtuese të tij. Ngarkesa e normuar mësimdhënëse sipas këtyre kategorive, për personelin me kohë të plotë të IKSHS është si më poshtë:

a. Kategoria “Profesor”	42 orë në auditor
b. Kategoria “Lektor”	50 orë në auditor
c. Kategoria “Asistent-Lektor”	59 orë në auditor.
2. Çdo orë e realizuar mbi këtë përcaktim konsiderohet e kategorizohet si orë suplementare. Orët suplementare në auditor në të cilat mund të angazhohet personeli akademik i IKSHS nuk mund të jenë më shumë se 100 orë.
3. Personeli akademik me kohë të plotë i IKSHS, mund të përfshihet në grupet e punës për hartimin dhe aplikimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkimit Evropian. Ngarkesa e paguar për përfshirjen në këto grupe pune është deri në 200 orë/projekte në vit (Kjo ngarkesë nuk përfshihet në llogaritjet e orëve maksimale të pikave 2 dhe 3 të këtij neni). Për shkrimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, grupit të punës i njihen deri në 350 orë të cilat ndahen ndërmjet anëtarëve të grupit të punës i cili është angazhuar për përgatitjen e projektit. Projekti përcakton si institucion menaxhues të tij, UST-në. Grupi i punës miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe Drejtori i IKSHS. Orët certifikohen vetëm pasi projekti ka certifikim formal të dorëzimit dhe merren komentet përpara i përket cilësisë së projektit, në rast se ai nuk rezulton fitues ose kur projekti rezulton fitues.
4. Mësimdhënia vjetore në auditor e autoriteteve të IKSHS, sipas emërteses është:

a. Drejtor	21 orë mësimore
b. Zëvendësdrejtor	27 orë mësimore
c. Drejtues departamenti	27 orë mësimore
5. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik me orientim kërkimor-shkencor nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, sipas përcaktimit të programeve të lëndës ose 2 lëndë vjetore.
6. Personeli akademik i cili angazhohet në veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, paguhet për ngarkesën e parashikuar si orë suplementare sipas normave ligjore e nenligjore ne fuqi.
7. Çdo angazhim i personelit akademik në veprimtari të pagueshme dhe që nuk është parashikuar dhe miratuar në buxhetin vjetor të UST-së, duhet të marrë përpara ushtrimin të veprimtarisë të miratuara nga drejtuesi i njësise baze , njësise kryesore dhe Rektoratit ku

me pas kerkohet edhe miratimi i Bordit të Administrimit.

8. Personeli akademik angazhohet në veprimtari kërkimore-shkencore, mësimdhënëse, institucionale, profesionale dhe veprimtari të tjera, sipas profilit të kualifikimit të tij akademik, kontratës së punës të lidhur me UST-në dhe marreveshjen vjetore te aktivitetit akademiko-shkencor.

Neni 36

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Kjo periudhë mund të përdoret si e tërë ose me pjesë.
3. Rregullimi i marrëdhënieve juridike ndërmjet palëve për këtë periudhë bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje në të cilën përcaktohen:
 - a. Kohëzgjatja e lejes sabatike;
 - b. Objekti i lejes sabatike;
 - c. Dokuemntacionin zyrtar mbështetës që vërteton objektin dhe arsyet e shkëputjes sabatike.

Neni 37

Personeli ndihmës-akademik

1. Personeli ndihmës-akademik në IKSHS ndahet në:
 - a. Personel ndihmës-akademik me karakter kërkimor (specialist/laborantët);
 - b. Personel ndihmës-akademik me karakter administrativ (specialist/asistenti i Drejtorit).
2. Marrja në punë e personelit ndihmës-akademik në IKSHS kryhet me konkurrim te hapur.
3. Nisja e procedurës së punësimit me konkurs publik për personelin ndihmës-akademik në IKSHS vendoset me urdhër të rektorit, pas marrjes së propozimeve nga Drejtori i IKSHS.
4. Kriteret e përgjithshme, specifike dhe procedurat për punësim për çdo kategori të personelit ndihmës-akademik në IKSHS kryhen sipas kuadrit rregullator për rekrutimet në UST.

Neni 38

Personeli ndihmës-kërkimor i IKSHS

Personeli ndihmës-kërkimor i IKSHS përbëhet nga:

1. Specialistë/laborantë
2. Specialisti/laboranti ka për detyrë:
 - a. Të sigurojë mbarëvajtjen e laboratorëve;
 - b. Të garantojë mirëfunksionimin e pajisjeve përmes njoftimit e kërkimit për riparimin në rast problemesh;
 - c. Të garantojë korrrektësinë dhe saktësinë e të dhënave e rezultateve që përftohen;
 - d. Të paraqesë kërkesat për pajisjen me mjete apo materiale të konsumueshme për vazhdimësinë e projekteve apo testimeve/analizave; si dhe;
 - e. Të sigurojë protokolle për testime, teste apo procedura laboratorike të reja apo të pakryera më parë, me urdhër apo kërkesë të grupeve kërkimore dhe/ose Drejtorit të IKSHS, dhe;
 - f. Detyra të tjera që i ngarkohen nga Drejtori i IKSHS;
 - g. Të ndjekë e kryejë në mënyrë korrekte proceset e matjeve, vlerësimeve, testimeve, analizave e provave në përputhje me protokollat e posacme;

- h. Të ndjekë e të informojë mbi gjendjen e pajisjeve, materialeve të konsumit, reagentëve e materialeve të tjera që përdoren në laborator;
- i. Të informojë mbi çdo problem që lidhet me sa më sipër përgjegjësën elabrororit dhe/ose Drejtorin e IKSHS;
- j. Të bashkëpunojë me përgjegjësën e laboratorit dhe konsultohet me të për çdo problem apo dyshim në lidhje me saktësinë e të dhënave.

Detyra dhe përgjegjësi më të detajuara parashikohen në rregulloren veçantë të administrimit të laboratorëve që hartohet në zbatim të kësaj rregullore.

Neni 39

Personeli administrativ

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të institucionit, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Punësimi i personelit administrativ bëhet me konkurs publik. Kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta dhe procedura e punësimit përcaktohen nga Bordi i Administrimit, mbështetur në Statutin dhe aktet e tjera rregulluese për rekrutimet të UST-së.
3. Të drejtat dhe detyrimet e personelit administrativ, përcaktohen në Rregulloren përkatëse të njësive ndihmëse për çështje ekonomiko-financiare dhe administrative, si dhe në kontratën individuale të punës, që nënshkruhet nga Administratori i UST-së.

Neni 40

Të drejtat e punonjësit ndihmës-akademik

Përveç të drejtave që parashikohen në Kushtetutë, Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit dhe në kontratën e punës, punonjësi ka edhe këto të drejta:

1. E drejta për një punë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në përputhje edhe me kushtet e përcaktuara në kontratën e punës.
2. E drejta për t'u ngritur në detyrë dhe për të lëvizur në mënyrë paralele.
3. E drejta për t'u trajnuar në lidhje me punën që kryen.
4. E drejta për të marrë pushimin e pagueshëm vjetor, të plotë ose të pjesshëm si edhe pushime të tjera të pagueshme.
5. E drejta për t'u vënë në dijeni për çdo informacion që ka lidhje me detyrën funksionale.
6. E drejta për të shprehur lirish pikëpamjet rreth çdo problemi që lidhet me detyrën që kryen.
7. E drejta për t'u organizuar e përfaqësu.

Neni 41

Detyrimet e punonjësit ndihmës-akademik

Në respektim të disiplinës në punë, punonjësi është i detyruar:

1. Të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe rregulloret e universitetit, si dhe me çdo dispozitë tjetër të parashikuar në aktet e tjera me përmbajtje normative, që rregullojnë veprimtarinë e tij.
2. Të zbatojë dhe përmbushë urdhrat e titullarit dhe të eprorit nga i cili ka varësi, si dhe të ndjekë këshillat e tyre që lidhen me procedurat e punës apo të kryerjes së detyrës.
3. Të mbrojë interesat dhe pasurinë e institucionit.
4. Të ndihmojë punonjësit e tjerë të universitetit dhe të bashkëpunojë me ta, në përputhje me praktikën e përgjithshme dhe rregullat e institucionit.
5. Të respektojë orarin e punës, vetëm me urdhër të titullarit, për nevoja të institucionit është i

- detyruar të punojë jashtë orarit zyrtar, të cilat do të kthehen në ditë pushimi ose ore te pagueshme me vendime te Rektoratit sipas kuadrit legjislativ ne fuqi .
6. Të informojë eprorin, në varësi të të cilit është, për çdo parregullsi në vendin e punës dhe defekt të teknikës së zyrës apo laboratorit.
 7. Të mbyllë të gjithë dokumentacionin apo mjetet e punës (në varësi të detyrës që kryen) përpara largimit nga vendi i punës, në mbyllje të orarit të punës.
 8. Detyrat e specifikuar për secilin punonjës ndihmës-akademik jepen në rregulloret e njësive përkatëse ku ai është i punësuar.

Neni 42

Shkeljet disiplinore të personelit të IKSHS

Përbëjnë shkelje disiplinore veprimet apo mosveprimet si vijon:

1. Mosrespektimi në mënyrë të përsëritur i kohës dhe i orarit të punës.
2. Moskryerja e detyrave ose mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara për kryerjen e detyrave.
3. Sjellja jo e rregullt gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit, studentët apo publikun.
4. Dëmtimi i pronës së institucionit, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar, apo keqpërdorimi i saj.
5. Kryerja, brenda ose jashtë kohës së punës, i veprimeve, të cilat çënojnë interesat e detyrës që ushtron punonjësi në universitet, ose të tilla që pengojnë përmbushjen e saj.
6. Shkelja e Kodit, Rregullores së Etikës.
7. Moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale.
8. Mosrespektimi i detyrave të tjera të parashikuara në statut, rregullore apo akte të tjera me përmbajtje normative që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së universitetit.

Neni 43

Masat disiplinore të personelit të IKSHS

1. Në rast të shkeljes së disiplinës në punë mund të merren këto masa disiplinore:
 - a. Tërheqje vëmendjeje (e cila mbahet në procesverbal);
 - b. Vërejtje me shkrim;
 - c. Paralajmërim për largim nga detyra;
 - d. Largim nga puna.
2. Masat disiplinore të përcaktuara përkatësisht në shkronjat (a), (b) dhe (c) mund të shlyhen, në qoftë se brenda një viti nga dita e dhënies së tyre nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja personale.

KREU V

Bashkëpunimi i IKSHS

Për të përmbushur misionin dhe detyrat e saj, IKSHS bashkëpunon ngushtë me njësitë e tjera kryesore të IKShS, me institucione e organizata profesionale e shkencore vendase e të huaja si dhe me insitucione donator të tjera që operojnë në fushën dhe objektin e IKSHS.

Neni 44

Bashkëpunimi me njësitë kryesore të UST

1. Në realizimin e programit të saj kërkimor dhe detyrimeve akademike mësimore, IKSHS bashkëpunon me fakultetet e UST: Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit.
2. Fusha e bashkëpunimit përfshin por nuk kufizohet vetëm në:
 - a. Realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore si përmes grupeve kërkimore ndër-fakultetore ashtu dhe atyre ndërdepartamentore të të dy njësive;
 - b. Koordinimit të projekteve të vecanta që lidhen me fusha të përafërta të kërkimit dhe bashkërendimin e produkteve dhe burimeve financiare.
 - c. Bashkëorganizimin e veprimtarive shkencore të përbashkëta në funksion të publikimit të produktit shkencor dhe kualifikimit të vazhduar të personelit akademik e kërkimor në UST;
 - d. Pjesëmarrjes reciproke në ofertën akademike të institucioneve respektive vecanërisht në realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë apo në kurse përditësimi e kualifikimi të thelluar e të vazhduar;
 - e. Fusha të tjera që palët i gjykojnë dhe për të cilat bien dakort paraprakisht dhe që nuk bien ndesh me kompetencat përkatëse; si dhe
 - f. Parashikime të tjera të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore dhe rregulloren e UST.
3. Të gjitha projektet apo bashkëpunimet mund të merren me nismën e titullarëve të njësive, sikurse mund të propozohen nga punonjësit apo drejtuesit e departamenteve respektive.
4. Marrëveshjet e lidhura në këtë kuadër mund të jenë semestrale, vjetore apo dhe më afatgjatë.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i veprimtarive të përbashkëta bëhet nga titullarët e njësive kryesore në bashkëpunim me njëri tjetrin dhe në konsultim me këshillat e njësive respektive.
6. Marrëveshjet e arritura si për projekte të vecanta ashtu dhe për programe afatgjatë, u bëhen të njohura stafit të dy njësive respektive në bashkëpunim.
7. Titullarët e njësive bashkëpunuese mund të hartojnë në fillim të çdo viti akademik një marrëveshje ku përcaktohen fushat e bashkëpunimit midis dy njësive në planin e mësidhenies dhe shkëmbimit të stafit mësidhënës, projekteve kërkimore shkencore dhe personelit të përfshirë në to dhe veprimtarive të tjera sipas rastit.

Neni 45:

Bashkëpunimi i IKSHS me institucionet dhe organizatat kombëtare

Për të përmbushur misionin dhe detyrat e saj edhe në planin kombëtar dhe në funksion të zgjerimit të fushave kërkimore e didaktike, IKSHS bashkëpunon me institucione kërkimore e universitare kombëtare si dhe me autoritetet shtetërore, profesionale që operojnë në fushat e Lëvizjes, Sportit e Shëndetit si me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqipëtar, Federata Sportive Kombëtare si dhe organizata të dedikuara në fushën e sportit dhe aktivitetit fizik.

Fusha e bashkëpunimit konsistojnë në:

1. Kryerjen e projekteve të përbashkëta kërkimore ndër-institucionale;
2. Realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore përmes grupeve kërkimore ndër-institucionale;
3. Koordinimit dhe partneritetit në projekte të vecanta që lidhen me fusha të përafërta apo përplotësuese të kërkimit;
4. Krijimin e kushteve për shkëmbim personeli e për pasurimin e përvojës akademike e kërkimore të tyre;

5. Bashkëorganizimin e veprimtarive shkencore të përbashkëta në funksion të informimit e publikimit shkencor dhe kualifikimit të vazhduar të personelit akademik e kërkimor respektiv;
6. Bashkëpunimin për ndikimin në politikat e zhvillimit të sportit, edukimit fizik e shëndetit në shkollat e të gjitha niveleve;
7. Realizimin e projekteve të mbështetura që nxitin zhvillimin e sportit elitare e cilësor; si dhe
8. Veprimtari e bashkëpunime të tjera që rrjedhin nga politikat e reja kombëtare në fushën e Sportit, Rekreacionit, Edukimit dhe Shëndetit.

Neni 46

Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare

Për të zgjeruar misionin dhe detyrat e saj edhe në vizibilitetin e dimensionin ndërkombëtar, për të hapur perspektiva të çmueshme zhvillimi në fushat e kërkimit që lëvrohen nga IKSHS, për të nxitur studimet, kërkimet e veprimtaritë shkencore e botuese, dhe kualifikimin e detyrar dhe të vazhduar të personelit të saj akademik, IKSHS ka për detyrë të vendosë e zgjerojë bashkëpunimin me institucione kërkimore e universitare ndërkombëtare, autoritetet botërore të studimeve dhe organizatat e mirënjohura profesionale si Federata Sportive Ndërkombëtare si dhe organizata të dedikuara në fushat e Lëvizjes, Sportit, Rekreacionit, Shëndetit dhe Turizmit.

Fusha e bashkëpunimit përfshijnë veprimtari të koordinuara si:

1. Aplikimin në partneritet e me projekte të përbashkëta në programe të vecanta europiane e ndërkombëtare që mbështetin arsimin e lartë dhe kërkimin;
2. Realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore përmes grupeve kërkimore ndër-institucionale;
3. Koordinimit dhe partneritetit në projekte të vecanta që lidhen me fusha të përafërta apo përplotësuese të kërkimit;
4. Krijimin e kushteve për shkëmbim personeli e për pasurimin e përvojës akademike e kërkimore të tyre;
5. Bashkëorganizimin e veprimtarive shkencore të përbashkëta në funksion të informimit e publikimit shkencor dhe kualifikimit të vazhduar të personelit akademik e kërkimor respektiv;
6. Antarësimin në organizata, rrjete apo organizime të tjera që përputhen me fushat dhe platformën zhvillimore të IKSHS dhe UST.
7. Procedurat dhe kriteret për bashkëpunimin me partner të jashtëm apo të huaj rregullohen sipas parashikimeve në aktet ligjore e nënligjore dhe në Statutin e Rregulloren e UST.

KREU VI VLERËSIMI I CILËSISË

Neni 47

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

1. Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit harton kriteret dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me politikat dhe procedurat e përcaktuara nga aktet kryesore rregullatore të UST.
2. IKSHS ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njërive përbërëse dhe personelit.
3. NJSBC në IKSHS përbëhet nga 3 anëtarë: Nje nga anetaret e NJSBCmerohet nga

- Drejtori i IKSHS-se ne rolin e drejtuesit te NJSBC. Drejtuesi i NJSBC-se se ISKSHS-se eshte edhe anetari i NJSBC-se se UST-se si perfaqesues i Institutit.
4. NJSBC bashkepunon ngushtesisht me GVB-te e ngrituara ne nivel te njesise kryesore per realizimin e raporteve periodike te sigurimit te cilesise ne Institut.
 5. IKSHS në fund të viti akademik nepermjet raporteve te hartura nga GVB dhe NJSBC vlerëson veprimtaritë kërkimore dhe plotësimin e standardeve të kërkuara për këtë qëllim.
 6. Standardet për sigurimin e cilësisë në kërkimin shkencor zbatohen në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR dhe aktet e institucioneve të vlerësimit të kërkimit në IAL-të si AKKSHI.
 7. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga NJSBC dhe GVB të IKSHS, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
 8. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit organizohet si rregull një herë në vit. Nëse është e nevojshme NJSBC mund të organizojë vlerësime të pjesshëm edhe më shpesh.
 9. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, veprimtaritë që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse te sigurimit te cilesise ne institucion.

Neni 48

Vlerësimi periodik i veprimtarive kërkimore-shkencore të IKSHS

Metodologjia dhe kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë/IKSHS kryhen në përputhje me përcaktimet e sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ky proces ndjek në të njëjtën linjë dhe proces ato të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) dhe zhvillohet në përputhje me kriteret e mëposhtme:

1. **Kriteri bibliometrik:**
 - a. Lista e artikujve të botuar në revista ndërkombëtare shkencore me faktor impakti, si dhe në revista akademike ndërkombëtare të indeksuara dhe të recensionuara;
 - b. Lista e artikujve të botuar brenda vendit në revista shkencore dhe buletine shkencore të njohura nga MASR;
 - c. Lista e monografive shkencore të botuara brenda vendit, të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;
 - d. Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës dhe të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;
 - e. Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar brenda vendit, si dhe të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë.
2. **Kriteri i impaktit të veprimtarisë kërkimore-shkencore:**
 - a. Lista e patentave apo e shpikjeve të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intektuale apo autoriteteve të huaja;
 - b. Lista e projekteve kërkimore-shkencore të fituara nga programet kuadër të BE-së për kërkim shkencor, si koordinator projekti ose si partner në projekt;
 - c. Lista e sipërmarrjeve të reja, të krijuara si rezultat e punës kërkimore-shkencore të njësive bazë;
 - d. Lista e kontratave të shërbimit me objekt studimor.
3. **Kriteri infrastrukturor:**
 - a. Lista e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;
 - b. Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune-kërkimi;
 - c. Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;
 - d. Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përfshirë edhe ato elektronike.
4. **Kriteri i kapaciteteve njerëzore:**

- a. Lista e personelit akademik të njësisë bazë me tituj akademike: "profesor", "profesor i asociuar", "lektor" dhe "asistent lektor", me kohë të plotë, në momentin e deklaramentit;
- b. Lista e konferencave shkencore ndërkombëtare të organizuara nga njësi bazë në bashkëpunim me homologët e saj, në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- c. Lista e konferencave shkencore kombëtare të organizuara nga njësi bazë;
- d. Lista e pjesëmarrjes së personelit akademik të njësisë bazë, me referime shkencore, në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- e. Lista e pjesëmarrjes me referime shkencore të personelit akademik të njësisë bazë në konferenca shkencore kombëtare;
- f. Lista e çmimeve ndërkombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- g. Lista e çmimeve kombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë;
- h. Lista e programeve të "Master ekzekutiv" dhe "Doktoratë";
- i. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore periodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- j. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore joperiodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- k. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore vendase, të njohura nga MASR-ja;
- l. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike vendase;
- m. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë të komiteteve shkencore të konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;
- n. Lista e recensuesve nga personeli akademik i njësisë bazë për artikujt shkencorë të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G20-ës;

5. Kriteri i ndërkombëtarizimit:

- a. Lista e studimeve dhe kërkimeve lëndore ose ndërdisiplinore të aplikuara me partner të vendeve të BE- së, OECD-së dhe të tjerë;
- b. Lista e personelit akademik të njësisë bazë, të angazhuar në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe BE-së, e matur person/në javë;
- c. Lista e personelit të huaj akademik të njësisë bazë nga vendet e OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësisë bazë, e matur person/në javë;
- d. Lista e programeve të studimit për "Master i shkencave" dhe të ciklit të tretë, të përbashkëta me IAL-të e huaja nga vendet e OECD-së dhe të BE-së, që përfundojnë me lëshimin e një diplome të përbashkët apo të dyfishtë.

Neni 49

Organizimi i vlerësimit

1. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) organizon, administron, monitoron dhe publikon rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësi bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor-ACRIS.
2. UST-ja pas marrjes së njoftimit nga AKKSHI, njofton dhe vendos afate për personelin

akademik të njësisë bazë, që të realizojë procesin përkatës të plotësimit të të dhënave të kërkuara, në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”, në platformën ACRIS.

3. Drejtuesi i njësisë bazë udhëzon, monitoron dhe ndjek të gjitha vetëdeklarimet e të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë, duke kërkuar nga të gjithë anëtarët përgjegjshmëri në plotësimin e informacionit, sipas kritereve të përcaktuara në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore- shkencore”.

Neni 50:

Detyrat dhe përgjegjësitë gjatë procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor

1. Drejtuesit e njësisë bazë dhe Drejtori i IKSHS gjatë procesit të vlerësimit duhet që:
 - a. Të caktojë një person kontakti brenda njësisë bazë që të ndjekë procesin e realizimit në afat të vlerësimit;
 - b. Të koordinojë, të monitorojë dhe të ndjekë procesin e hedhjes së të dhënave nga personeli akademik i njësisë bazë brenda afatit të përcaktuar.

Neni 51:

Organizimi i procesit të vlerësimit periodik të kërkimit shkencor

1. Anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë do të kenë akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur, për vetëdeklarimin e veprimtarisë kërkimore– shkencore të drejtimeve kryesore të fushave të kërkimit dhe të disiplinave specifike.
2. Drejtuesi i njësisë bazë ka akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur që shërben për ndjekjen dhe monitorimin e të dhënave të deklaruara nga anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë.
3. AKKSHI është përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën Ndërinstitucionale të RASH-it për administrimin e portalit, sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave të publikuara, zbatimin e standardeve të përgjithshme të vlerësimit dhe certifikimin e rezultateve të vlerësimit.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 52

Rregulloret e Departamenteve

Rregullimi i mëtejshëm i të drejtave dhe detyrimeve të autoriteteve drejtuese të departamenteve në përputhje me Statutin e UST-së dhe këtë rregullore, do të bëhet nga rregulloret e departamenteve dhe të njësisë të tjera, të cilat hartohen nga departamentet përkatëse dhe miratohen në Senatin Akademik.

Neni 53

Interpretimi i Rregullores

Të drejtën për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Drejtori/Drejtorja e IKSHS dhe Rektori i UST-së.

Neni 54

Miratimi dhe ndryshimi i Rregullores

Rregullorja e Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit miratohet dhe ndryshohet nga Senati Akademik i UST-se me propozim të Drejtorit të IKSHS.

Neni 55

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin veprimtarinë duke filluar nga viti akademik 2020 – 2021.